

**Për: Universitetin Publik "Kadri Zeka" në Gjiilan  
Këshillin e Fakultetit Juridik**

**Nga: Komisioni i Ankesave**

**Lënda: Raport për shqyrtimin e ankesave të kandidatëve për profesor dhe asistent të angazhuar për vitin akademik 2020/2021 sipas konkursit publik**

Komisioni i Ankesave në përbërje: 1. Prof.Ass.Dr. Albulena Hajdari Krasniqi, Kryetare, 2. Prof.Ass.Dr. Fatmire Krasniqi anëtare dhe 3. Ass.PhD.Cand Detrina Alishani Sopi anëtare, në mbështetje të nenit 15 të *Rregullores mbi Procedurat e Angazhimit të Bashkëpunëtorëve të Jashtëm - me Honorar në Universitetin Publik "Kadri Zeka" në Gjiilan*, në mbledhjen e mbajtur, datë 22.10.2020, pas shqyrtimit të të gjitha ankesave të parashtruara nga kandidatët për angazhim në Fakultetin Juridik për vitin akademik 2020/2021 sipas Konkursit me Nr.Ref.01/1182, të datës 24.09.2020, paraqiti:

**R A P O R T  
PËR SHQYRTIMIN E ANKESAVE  
PËR ANGAZHIMIN E BASHKËPUNËTORËVE TË JASHTËM – ME HONORAR**


**1. Ankesat për pozitat e mësimdhënësve:**

Komisioni i Ankesave ka shqyrtuar dhe vlerësuar ankesat dhe ka konstatuar si në vijim:

**Pozita III/4:**Tre mësimdhënës për semestrin dimëror dhe veror për lëndët: E drejta familjare dhe trashëgimore, Klinika juridike civile, E drejta tregtare, E drejta e procedurës civile, E drejta romake, E drejta civile, E drejta detyrimore, E drejta sendore, E drejta e procedurës civile – Pjesa e posaçme, E drejta kontraktore, E drejta e pronësisë intelektuale dhe Hyrje në të drejtën civile.

Për këtë pikë të konkursit ka ushtruar ankesë kandidati **Prof. Asoc. Dr. Muharem Faiku**, me pretendimin se kërkesa e tij për angazhim si mësimdhënës në lëndët: E drejta civile, E drejta familjare dhe trashëgimore, E drejta sendore, E drejta detyrimore, E drejta kontraktore dhe Hyrje në të drejtën civile është refuzuar edhe përkundër faktit se i njëjti ka thirrjen akademike Profesor i asocuar si dhe përkunder faktit të ekzistimit të marrëveshjes në mes të dy Universiteteve Publike.

Pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore të kandidatit dhe shqyrtimit të dosjeve të kandidatëve, veçanërisht të kandidatëve të pranuar për Pozitën III/4, Komisioni i Ankesave vlerëson se në procedurën e përzgjedhjes së kandidatëve nga ana e Komisionit Vlerësues nuk janë evidentuar shkelje sikurse pretendon kandidati në ankesë, mirëpo i njëjti është refuzuar për shkak të mos kompletimit të dokumenteve të kërkuara në konkurs. Rrjedhimisht, Komisioni konstaton se ankesa e kandidatit është e papabuar.




**Anëtarët e Komisionit të Ankesave:**

1. Prof. Ass. Dr. Albulena Hajdari Krasniqi, Kryetare: \_\_\_\_\_

2. Prof. Ass. Dr. Fatmire Krasniqi, Anëtare: \_\_\_\_\_

3. Ass. PhD. Cand. Detrina Alishani, Anëtare: \_\_\_\_\_



*Handwritten signatures in blue ink, corresponding to the three members listed on the left.*

Gjilan, 22.10.2020